



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorëzuar Primijshe/Prodato Received/Delivery	21.10.2022	viti god year	2
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	6380/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.778/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.778/2022 të datës 08.09.2022 të parashtruar nga ankuesja

Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me Nr.14-117/01-0205258/22 të datës 26.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Transferim i Përkohshëm", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 21.10.2022, mori këtë

### V E N D I M

I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.778/2022 e datës 08.09.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me Nr.14-117/01-0205258/22 i datës 26.08.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën "Zyrtare e Lartë e Prokurimit" sipas Akt Emërimit të datës 10.03.2017 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e tij e punës.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Ar sy e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Prishtinës, më datë 08.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5213/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-117/01-0205258/22 të datës 26.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për transferim të përkohshëm, me pretendimet se vendimi është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.09.2022 ka dërguar kërkesën e ankueses për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës. Ndërsa Këshilli, më datë 06.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.09.2022 me numër protokolli 5213/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me Nr.14-117/01-0205258/22 i datës 26.08.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt Emërim i A.B. i datës 10.03.2017; Kontratë për Punë e A.B. me 01Nr.112-917 i datës 27.05.2011; Kontratë për Punë e A.B. me 01Nr.112-917 i datës 21.02.2011; Akt Emërim i A.B. i datës 31.01.2013; Certifikatë e avancuar profesionale për prokurim e A.B. me nr. 019 e vitit 2020; Certifikatë e avancuar profesionale për prokurim e A.B. me nr. 12 e vitit 2015; Certifikatë Themelore profesionale për prokurim e A.B. me nr. 022 e vitit 2017-2019; Certifikatë Themelore profesionale të prokurim e A.B. me nr. 015 e muajit Qershor 2013; Certifikatë nga Ministria e Financave për A.B. e datës 03.03.2014; Certifikatë nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve për A.B. e datës 22-23 mars 2022; Certifikatë për A.B. e datës 06.14 Nëntorë 2018; Letër Rekomandim nga Ndërmarrja Publike Lokale Sport Marketing për A.B. me nr.112 i datës 24.06.2022; Kontratë për Kryerjen e Shërbimit nga Ndërmarrja Publike Lokale Sport Marketing për A.B. e datës 27.04.2022; Diplomë nga Kolegji AAB-RIINVEST e A.B. me nr.224/10 e datës 19.08.2010; Diplomë nga Kolegji AAB e A.B. me nr. 184/13 e datës 03.05.2013; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë i Prokurimit i datës 12.07.2022; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën Zyrtar i Prokurimit 2 i datës 12.07.2022; E-mail nga M.Ll për A.B. i datës 06.09.2022; E-mail nga A.B. për M.Ll. i datës 07.09.2022; E-mail nga M.Ll për A.B. i datës 06.09.2022; E-mail nga M.Ll. për B.C. i datës 07.09.2022; E-mail nga A.B. për M.Ll. i datës 07.09.2022; Konkurs Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim Profesional 1 i datës 12.08.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.09.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 5940/2022 e datës 06.10.2022; Vendim për A.B. me Nr.01-112-917 i datës 21.02.2011; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën Udhëheqës i Prokurimit; E-mail nga M.Ll. për A.B. i datës 06.09.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave materiale të kësaj lënde, ka konstatuar se ankuesja sipas Akt të Emërimit të datës 10.03.2017 është e punësuar në pozitën "Zyrtare e Lartë e Prokurimit" në Komunën e Prishtinës, ndërsa Kryetari i Komunës së Prishtinës më datë 26.08.2022 ka nxjerr Vendim me Nr.14-117/01-0205258/22 me të cilin ka bërë

transferimin e përkohshëm të ankueses nga pozita "Zyrtare e Lartë e Prokurimit" në pozitën "Zyrtare e Lartë për Planifikim" në kuadër të Drejtorisë së Parqeve dhe e njëjta me datë 06.09.2022 përmes zyrtares së personelit në Komunën e Prishtinës është njoftuar lidhur me vendimin e Kryetarit të Komunës për transferim të përkohshëm.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-117/01-0205258/22 të datës 26.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës për transferim të përkohshëm, pretendon që ky transferim është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi respektivisht me nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyratë Publik, në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse e ka nxjerr personi jo kompetent, po ashtu kriteret e kërkuara për pozitën në të cilën është transferuar ankuesja nuk i përmbush kualifikimin e nevojshme, sikurse akti i kontestuar është akt i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon që Vendimi me Nr.14-117/01-0205258/22 i datës 26.08.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës për transferim të përkohshëm është nxjerr në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil sepse e ka nxjerr personi jo kompetent, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë transferimin e nëpunësve civil gjegjësisht sipas nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë është përcaktuar se: *"Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësia përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësisht nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet"*, në këtë kontekst e në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyratë Publikë njësia përgjegjëse konsiderohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, andaj edhe vendimi është nxjerr nga personi jo kompetent dhe si i tillë është i kundërligjshëm, kështu që pretendimi i ankueses është i bazuar.

Po ashtu, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankueses e cila pretendon se nuk përmbush kriteret e përcaktuara që kërkohen për ushtrimin e pozitës në të cilën është transferuar "Zyrtare e Lartë për Planifikim" në kuadër të Drejtorisë së Parqeve, sipas konkursit të datës 12.08.2022 të shpallur nga Komuna e Prishtinës për pozitën: *"Zyrtare e Lartë për Planifikim dhe Zhvillim" si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë të përcaktuara: Diplomë Universitare me të paktën 240 kredi apo ekuivalente me to, Arsimi i posaçëm formal: Fakulteti i Arkitekturës" dhe 2 vite përvojë punë profesionale"*, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesja sipas Diplomës me numër:224/10 të datës 19.08.2010 dëshmohet se e njëjta ka mbaruar studimet themelore universitare në Kolegjin AAB-RIINVEST në programin Banka, Financa dhe Kontabilitet dhe ka marr titullin: Bachelor i Shkencave në Banka, Financa dhe Kontabilitet, po ashtu sipas Diplomës me numër.184/13 të datës 03.05.2013 dëshmohet se e njëjta ia ka përfunduar studimet Post Diplomike - Master në Kolegjin AAB-RIINVEST në Lëmin Tregjet Financiare dhe Bankat dhe ka marr titullin: Master në Tregjet Financiare, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Vendimi me Nr.14-117/01-0205258/22 i datës 26.08.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës përveçse është nxjerrë në kundërshtim me autorizimet ligjore, i njëjti është nxjerrë edhe në

kundërshtim me neni 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë është përcaktuar se: "...Për marrjen e këtij vendimi njësia përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësisht nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet" ngase ankuesja nuk i ka plotësuar kriteret e posaçme të arsimit formal ndërlidhur me kualifikimin e nevojshme për ta ushtruar pozitën në të cilën është transferuar sikurse edhe përvojën e caktuar profesionale të ngjashme me kualifikimin profesional për fushën e kërkuar, rrjedhimisht e njëjta nuk është e kualifikuar apo nuk posedon diplomë të Fakultetit të Arkitekturës, rrjedhimisht pretendimi ankimor i ankuseses është i bazuar edhe mbi këtë bazë.

Andaj, bazuar si më lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë nga organi që nuk ka kompetencë, me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale është akt administrativ i paligjshëm, kështu që Këshilli me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, e duke u bazuar në autorizimet e përcaktuara me nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka shfuqizuar Vendimin me Nr.14-117/01-0205258/22 të datës 26.08.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, duke obliguar këtë të fundit që brenda afatit të përcaktuar si në pikën III të dispozitivit ta kthejë ankuesen në pozitën "Zyrtare e Lartë e Prokurimit" sipas Akt Emërimit të datës 10.03.2017 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me A.nr.778/2022

Çlirim ZEKA  
  
Procesmbajtës

  
Eshref SHABANI  
  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.